



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 675/Prot.
1

Tiranë, më 22/07/2015

VENDIM
“Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 44, datë 22/07/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Instituti Shqiptar i Shkencave, përfaqësuar nga Znj. _____, Drejtore Ekzekutive, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr.675 Prot., datë 09.07.2015 me objekt, “Ankim për refuzimin ndaj dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, ndaj Partive Politike, përkatësisht Partisë Socialiste të Shqipërisë, Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim. Ankuesja në cilësinë e kërkueses me kërkesat datë 09.06.2015, drejtuar Partisë Socialiste të Shqipërisë, Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, ka kërkuar të informohet lidhur me:

- listën e dhuruesve të fondeve jo publike të përfituara prej datës 21.05.2015 në vlerën mbi 100000 (njëqind mijë) lekë ose shërbime apo sende të barasvlefshme me të;
- listën e çdo shpenzimi të kryer eventualisht prej datës 21.05.2015 me fonde të përfituara nga buxheti i shtetit 2015.

Komisioneri pas vlerësimit të ankesës konstatoi se, ankuesja ka kërkuar të informohet në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, lidhur me informacionin i cili administrohet nga organizata të cilat në kuptim të këtij ligji konform nenit 2 të tij, për nga mënyra e organizimit të tyre, funksionimit dhe kuadrit ligjor rregullator, nuk përkufizohen si Autoritete Publike.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

- Rrëzimin e ankesës nr. 675 Prot., datë 09.07.2015 të Institutit Shqiptar të Shkencave

2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 22.07.2015.


Besnik DERVISHI
KOMISIONERI


TIRANË